



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/185

Datë: 25.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja 177 e Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim TRIAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/185

Datë: 25.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Gjykatës speciale.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/185

Datë: 25.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për zgjedhjen e Drejtorit të Qendrës Kulturore të Kosovës për diasporën dhe mërgatën.
2. Obligohet Ministria e Diasporës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/185
Datë: 25.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura të Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

 Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës


Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/185

Datë: 25.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Tremujor i Buxhetit për vitin 2014.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/185
Datë: 25.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Vjetor për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin për vitin 2013.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/185

Datë: 25.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2014, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë nr. 19/181 i datës 2 prill 2014

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë nr. 19/181 i datës 2 prill 2014 si në vijim:
pas pikës 2. të vendimit **shtohen edhe tri pika** si në vijim:
 - 1.1. Të gjithë studentët që fillojnë studimet në Universitetet Publike **në vitin e parë do t'a kenë falas;**
 - 1.2. Numri i studentëve që përfitojnë bursa do të rritet nga 1000 (një mijë) në 1500 (një mijë e pesëqind);
 - 1.3. Familjet kosovare që kanë më tepër se një student në universitete do të paguajnë **vetëm për një student**, ndërsa për studentët tjerë nuk do të paguajnë. Të gjithë fëmijët tjerë studentë të rinj do të studiojnë pa pagesë.
2. Dhe pika 1. e Vendimit zëvendësohet me këtë tekst: Të ulet pagesa për semestra për studentët e studimeve **Bachelor, Master dhe Doktoraturë në shumë prej 50 %** .
3. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/185

Datë: 25.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2014, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe Plotësimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/182 të datës 11 prill 2014

1. Ndryshohet pika 2. e Vendimit të Qeverisë nr. 04/182 i datës 11 prill 2014 dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim: Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga shpenzimet e paparashikuara të Qeverisë, kategoria ekonomike rezervat në shumë 300,000.00 (treqind mijë) euro dhe pjesa tjetër 200,000.00 (dyqind mijë) euro nga kategoria kapitale, mjetet barten në Departamentin e Thesarit prej nga transferohen në organizatën britaneze British Council, dega në Kosovë.
2. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi dhe ministritë e linjës për zbatimin e projektit.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/185

Datë: 25.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 38 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës jep opinion dhe pajtohet me kandidaturat e propozuara nga Paneli Seleksionues për përzgjedhjen e anëtarëve jo ekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës si në vijim:
 - 1.1. **Mejdi Bektashi;**
 - 1.2. **Mimoza Mustafa;**
 - 1.3. **Behxhet Brajshori dhe**
 - 1.4. **Shyqri Bytyqi.**
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/185

Datë: 25.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 23 të Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2014, mori:

V E N D I M

Për themelimin e Këshillit për Banim

1. Themelohet Këshilli Qendror për Banim si organ këshillëdhënës në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në këtë përbërje:

1.1.	Xhevat Azemi,	kryesues;
1.2.	Anton Berishaj,	anëtar;
1.3.	Besnike Koçani,	anëtare;
1.4.	Xhevat Shala,	anëtar dhe
1.5.	Petrit Balija	anëtar.
2. Organizimi dhe Funksonimi i Këshillit Qendror për Banim përcaktohet me Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Qendror të Banimit e cila aprovohet nga Qeveria e Kosovës.
3. Sekretaria e Këshillit Qendror për Banim caktohet nga Departamenti i Banimit dhe Ndërtimit.
4. Këshilli Qendror për Banim dhe anëtareve të Sekretarisë i takon kompensimi në formën e mëditjeve për çdo takim.
5. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/185

Datë: 25.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 04/L-219 për të huajt, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2014, mori:

V E N D I M

Për themelimin e Komisionit të Ankesave për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave që parashtrihen nga të huajt në zbatim të Ligjit nr. 04/L-219 për të huajt.

1. Themelohet Komisioni i Ankesave për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave që parashtrihen nga të huajt në këtë përbërje:
 - 1.1. Shkodran Manaj, Ministria e Punëve të Brendshme, kryesues;
 - 1.2. Mirsada Voca, Ministria e Punëve të Jashtme, zëvendës kryesuese;
 - 1.3. Liridona Ajeti, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtare;
 - 1.4. Burim Gashi, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, anëtar dhe
 - 1.5. Agron Gashi, Zyra e Kryeministrit, anëtar.
2. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për të huajt lidhur me:
 - 2.1. Refuzimin e leje qëndrimit të përkohshëm, duke përfshirë revokimin e leje qëndrimit të përkohshëm;
 - 2.2. Refuzimin e lëshimit të vizës;
 - 2.3. Refuzimin e lëshimit të dokumentit të udhëtimit për të huajt;
 - 2.4. Refuzimin e hyrjes në Republikën e Kosovës;
 - 2.5. Lëshimin e urdhër largimit vullnetar apo me forcë, duke përfshirë edhe masën lidhur me afatin e ndalimit të hyrjes;
3. Komisioni mbledhet me kërkesë të kryesuesit apo zëvendës-kryesuesit.
4. Komisioni merr vendime kur janë të pranishëm shumica e anëtareve të tij. Në rast të votave të barabarta, vota e kryesuesit vendos.

5. DSHAM/MPB luan rolin e sekretariatit të komisionit dhe të njëjtit i ofron kushtet teknike për ushtrimin e përgjegjesisë.
6. Komisioni gjatë ushtrimit të përgjegjësive sipas pikës 3. të këtij vendimi e zbaton Ligjin nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Ligjin nr. 04/L-219 për te Huajt dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij.
7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 122/2012 i datës 09 mars 2012 për Themelimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të huajve dhe vendimet nr. MPJ-ZPS/176/2013 i datës 13 gusht 2013 dhe vendimi nr. MPJ-ZPS/186/2013 i datës 03 shtator 2013 për shqyrtimin e ankesave të huajve lidhur me refuzimin e vizave, të nxjerra nga Ministria e Punëve të Jashtme.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/185

Datë: 25.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligji nr. 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti për Funkcionimin e Sistemit të Auditimit Brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2013.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/185

Datë: 25.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim kërkesa e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës për nismën e lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Italisë për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes dhe forcave të sigurisë.
2. Obligohet Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë